

MANJOLA NAÇO



Drejtoreshë, Departamenti i Auditimit të Pushtetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm, në KLSH.

Lindur ne vitin 1969. Diplomuar në Ekonomi, dega Financë- Kontabilitet

21 vite eksperience pune. Doktore e Shkencave

Ekonomike dhe Profesoreshë e Asociuar. Përveç aktivitetit akademik në fusha si kontabiliteti drejtimi dhe kontabiliteti i institucioneve financiare, Komiteti i Kontrollit të Bankës së Kursimeve(1994-1997), Komisionere në Komisionin e Letrave me Vlerë (2001-2005), Komisioni i Çertifikimit të Audituesve të Brendshëm Publikë(2007-2010), Këshilli i Profesorëve të Fakultetit Publik. Autore e disa librave në Kontabilitet dhe Sigurime.

Në KLSH. nga muaji maj 2013 me detyrë Drejtore Departamenti.

Fusha e ekspertizës: Kontabilitet, Auditim dhe Standarde Ndërkombëtare të këtyre fushave.

ZBATUESHMËRIA E MASAVE ORGANIZATIVE DHE MASAVE ADMINISTRATIVE/DISCIPLINORE TË KLSH GJATË VITEVE 2008-2012¹

nga Manjola Naço

Në përfundim të procesit të kontrollit dhe në varësi të gjetjeve të tij, KLSH gëzon të drejtën për të rekomanduar masa të karakterit organizativ, administrativ/disciplinor si dhe masa për zhdëmtim ekonomik. Gjithashtu, ky institucion mund të propozojë dhe rekomandojë ndryshime apo përmirësime të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Open Data Albania ka marrë në shqyrtim ecurinë e masave organizative dhe masave administrative e

disiplinore të lëshuara nga KLSH gjatë viteve 2008-2012 si dhe masën e zbatimit të tyre.

Masat organizative nënkuptojnë rekomandimet e KLSH-së për përmirësimin e sistemit të menaxhimit, drejtimit, organizimit të punës si dhe kontrollit të brendshëm të njësisë së audituar. Tabela në vijim paraqet masat organizative totale të dhëna për vitet 2008-2012 si dhe nivelin e zbatimit të tyre.

| | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 |
|--|--------|--------|--------|--------|--------|
| Masa organizative të rekomanduara gjithsej | 1,169 | 1,254 | 1,525 | 1,605 | 2,194 |
| Ndryshimi ne % i masave organizative te rekomanduara | | 0.0727 | 0.2161 | 0.0525 | 0.367 |
| Masa organizative te zbatuara | 925 | 875 | 1,256 | 1,093 | 1,659 |
| % e zbatimit te masave organizative | 79.13% | 69.78% | 82.36% | 68.1% | 75.62% |

Burimi : Kontrolli Lartë i Shtetit

Përpunimi dhe komentet: ODA

Sikurse mund të vihet re, numri i rekomandimeve në formën e masave organizative ka ardhur në rritje nga viti në vit, për të arritur vlerën maksimale në vitin 2012, me 2194 masa. Ndërkohë, niveli i zbatueshmërisë së tyre duket se nuk ka pasur të njëjtën tendencë. Kështu, nga 79% në 2008-n, ajo është ulur në rreth 75% për 2012-n. Megjithatë, gjatë analizës duhet mbajtur parasysh se numri më i lartë i masave të rekomanduara rrit edhe shkallën e vështirësisë në përmbushjen e të gjitha masave. Kështu, nga krahasimi në vlera absolute, 2012-a shënon edhe vitin me më shumë masa të zbatuara, 1659, rreth 556 më shumë se në 2011 dhe 1.8 herë më shumë se në 2008-n.

Masat administrative dhe disiplinore paraqesin një interes të vecantë, pasi ato lidhen me personat përgjegjës që kanë shkaktuar dëmin e konstatuar nga ana e KLSH-së, qoftë ky ekonomik apo jo. Ato variojnë nga 'Vërejtje me shkrim', në 'Vërejtje me paralajmërim', e deri në 'Largim nga detyra' dhe 'Largim nga puna'. Në këtë kategori përfshihen gjithashtu gjobat administrative në favor të shkaktarëve të dëmit. Edhe ecuria e zbatueshmërisë së këtij treguesi për vitin 2012 nuk kanë qenë e kënaqshme.

Nga 78% në 2008-n, ajo arriti në 80% në 2010-n, ndërsa në vitin 2012 shënoi nivelin më të ulët me rreth 70%. Megjithatë, sërish duhet të silllet në vëmendje rritja e numrit të masave administrative e disiplinore të lëshuara sidomos vitin e fundit, të cilat arritën në 1221, rreth 69% më shumë se në 2011-n.

| | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 |
|--|--------|--------|--------|---------|--------|
| Masa administrative dhe disiplinore te rekomanduara gjithsej | 894 | 835 | 847 | 720 | 1221 |
| Ndryshimi ne % i masave administrative dhe disiplinore te rekomanduara | | -6.6% | 1.44% | -14.99% | 69.58% |
| Masa administrative dhe disiplinore te zbatuara | 699 | 627 | 684 | 536 | 860 |
| % e zbatimit te masave administrative dhe disiplinore | 78.19% | 75.09% | 80.76% | 74.44% | 70.43% |

Burimi : Kontrolli Lartë i Shtetit

Përpunimi dhe komentet: ODA

Nga një hulumtim më i detajuar i zbatimit të masave administrative dhe disiplinore sipas llojit për vitin 2012, vihet re se niveli më i ulët i përket zbatimit të masave 'Largim nga shërbimi civil' (zbatuar 5 nga 27 të rekomanduara, apo 18,5%), 'Largimi nga puna' (zbatuar 53 nga 121, apo 43.8%) dhe 'Masa administrative-gjoha' (zbatuar 82 nga 146, ose 56.2%). Për vetë karakteristikën e tyre, më problematike situata shfaqet në zbatimin e masave 'Largim nga puna' ku personat përgjegjës që kanë kryer dëm ekonomik dhe shpërdoruar fondet publike vazhdojnë ende të qëndrojnë në vendet e tyre të punës, pavarësisht evidencave të gjetura nga KLSH. Nëse këtij fakti i shtohet edhe efekti domino i mungesës së ndëshkimit të personave përgjegjës, situata do të ishte akoma më problematike se sa duket.

ⁱ Publikuar në Open Data Albania, 12 Shtator 2013